

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM  
ODLUKA JE PRAVNOSNAZNA  
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD  
FERIZAJ / UROSEVAC

P.nr.2558/17

Më  
Dana

09 - 03 - 2018



### NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal-** në përbërje prej gjyqtarit individual Elmaz Zenuni, me Zyr.ligjor Gazmend Bytyqi, në çështjen penale kundër të pandehurit [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna e Suharekës, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II nr. 2242-2/16 të datës 11.10.2017, për shkak të veprës penale vjedhja e pyllit nga neni 358 par.1 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me Kërkesën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II nr. 2242-2/16 të datës 11.10.2017, për dhënjen e Urdhërit Ndëshkimor, më datën 09.01.2018 mori:

### A K T G J Y K I M

**PRANOHET** Kërkesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II nr. 2242-2/16 të datës 11.10.2017, gjykata jep:

### URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri, [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna e Suharekës , e lindur më [REDACTED] nga babai [REDACTED], ka të kryer shkollën fillore i gjendjes së varfér ekonomike, shtetas i Republikës së Kosovës.

## ËSHTË FAJTORE

Sepse më datën 02.11.2016 rreth ores 15:30 në pyllin public në vendin e quajtur "Ngastra 18" në Rajonin e Ekonomisë Pyjore,Nerodime –jezercështë takuar duke prerë 1 copë dru trung të ahut të njom me diameter 64 cm, me vëllim të përgjithshëm 3.36 metra kub në vlerë prej 490.05 euro, drunjët kanë qenë të prerë me sharrë motorike të cilat i ka transportuar me traktor [REDACTED] me rimorkio

**Me të cilën ka kryer veprën penale vjedhja e pyllit nga neni 358 par.1 të KPRK-së.**

Andaj, gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 41, 43, 46 dhe 73 të KPRK-së dhe neneve 365 e 495 të KPPRK-së të pandehurin gjykata e:

## GJYKON

**DENIM ME GJOBË** në lartësi prej 200 euro(me shkronja dyqind euro) i cili denim ekzekutohet në afat prej 15 dite nga dita kur aktgjykimi merr formën e prerë.

Nëse dënim me gjobë nuk mund të ekzekutohet në format tjera sipas nenit 46 par.3 të KPRK-së, i njëjti do t'i shndërrohet në dënim me burg ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet nga një (1) ditë burg.

Obligohet i pandehuri që në emër të kërkesës pasuroro-juridike të dëmtuarës DBP-zyra në Ferizaj të i kopmenoj dëmin e shkaktuar të dispozitivit të këtij aktgjykimi në shëm prej 490.05 Euro (me shkronja:katërqind e nënddhjetë euro e pesë cent) në afat prej 15 dite nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë nën kërcënim të ekzekutimit me detyrim .

I pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, në afatin prej 15 ditëve nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

## A R S Y E T I M

Prokurorisë Publike komunale në Ferizaj ka akuzuar të pandehurën me akuzën e vetë PP/II nr. 2242-2/16 të datës 11.10.2017, [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna e Suharekës, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II nr. 2242-2/16 të datës 11.10.2017, për shkak të veprës penale vjedhja e pyllit nga neni 358 par.1 të KPRK-së, e njashtu, ka ushtruar Kërkesë për dhënjen e Urdhërit Ndëshkimor PP/II nr. 2242-2/16 të datës 11.10.2017 me arsyetim se ka prova të besueshme nga Kallëzimi penal që e vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga i pandehuri.

Gjykata me rastin e shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe Kërkesës për dhënjen e Urdhërit Ndëshkimor, gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për dhënjen e Urdhërit Ndëshkimor në kuptim të nenit 493 par.1 të KPPK-së.

Gjykata, duke vlerësuar Kallëzimin penal të DBPZH-APK-Zyra në Ferizaj 651/2016 të dt.23.11.2016, si dhe fotot të cilat gjinden në shkresat e lëndës vërtetoi pa mëdyshje se i pandehuri ka kryer veprën penale vjedhja e pyllit nga neni 358 par.1 të KPRK-së .

Andaj, gjykata të njejtin e shpalli fajtor dhe konform nenit 495 të KPPRK-së i shqiptoi dënimin me gjobë të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Prandaj, duke u mbështetur në nenin 498 të KPPRK-së , gjykata i shqiptoi të pandehurit denimin me gjobë,pasi që gjykata vlerësoi shkresat e lëndës dhe konstatoi se ekzistojnë prova të besueshme se i pandehuri e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet dhe me aktgjykim me Urdhër ndëshkimor e ka shpallur fajtor dhe e ka denuar me denim sipas ligit.

Në bazë të nenit 458-460 të KPPRK-së, i pandehuri në emër të kërkesës pasuroro-juridike për kompensimin e dëmit të dëmtuarës Drejtoria për Bujqësi,pylltari-Zyra në Ferizaj obligohet që të ia kompensoj dëmin e shkaktuar në lartësi prej 490.05 euro.

Konform nenit 450-451 të KPPRK-së, i pandehuri është i obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, në afatin prej 15 ditëve nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Nga arsyet e lartëshenura u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

P nr.2558/17, datë 09.01.2018

Zyr.ligjor

Gazmend Bytyqi

Gjyqtari,

Elmaz Zenuni.



#### Këshilla juridike:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet Kundërshtim në afat prej 8 dite nga dita e pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës Themelore në Ferizaj.

I dëmtuari mund të e ushtroj Ankesë vetëm sa i përket Vendimit për sankcionin penal.